



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 842 prot.

Tiranë, më 21.02.2023

**VENDIM**

**Nr. 7 datë 21.02.2023**

**PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR  
DHËNIEN E LICENCËS SË TRANSMETIMIT AUDIO ANALOGE”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1/“ë” dhe 16 si dhe nenit 65 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e rregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi i AMA-s nr. 153, datë 18.07.2016, “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Armela**

**KRASNIQI**

**Zëvendëskryetar:**

**Desada**

**METAJ (në mungesë)**

**Anëtarë:**

**Aurela**

**BICJA**

**Besian**

**ZOGAJ**

**Gjergji**

**HAMITI**

**Jetmir**

**HALILAJ**

**Joana**

**ALLUSHI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**RREGULLORE**

**PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR DHËNIEN E LICENCËS SË  
TRANSMETIMIT AUDIO ANALOGE**

**KREU I  
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të neneve 59, 60, 61 dhe 65 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Neni 2  
Objekti**

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, kritereve dhe procedurave për:

- i. Dhënie e licencës të transmetimit audio analoge
- ii. Rinovimin e licencës së transmetimit audio
- iii. Zgjerimin ose ndryshimin e kushteve të licencës të transmetimit audio analoge

**Neni 3  
Përkufizime**

Termet e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Neni 4  
Llojet e licencave të transmetimit audio analoge**

1. Licenca e transmetimit audio analoge përbëhet nga:
  - a. Licenca e shërbimit të programi audio.
  - b. Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.
2. Në varësi të zonës së mbulimit me sinjal licenca e transmetimit audio analoge ndahet në:
  - a) Kombëtare, kur mbulohet me sinjal jo më pak se 80 për qind e territorit të vendit.
  - b) Rajonale, për mbulim deri në 4 (katër) qarqe me vazhdimësi gjeografike.
  - c) Lokale, për mbulimin deri në 1 (një) qark.

## Neni 5

### Kohëzgjatja e licencës dhe afatet për daljen në transmetim

Faqe | 3

1. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së një licence të lëshuar sipas kësaj rregulloreje për transmetim audio analoge prej AMA-s në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje do të jetë për një periudhë prej 7 vitesh.

2. I licencuari për transmetim audio kombëtar, duhet të fillojë transmetimin 12 muaj pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence.

3. I licencuari për transmetim audio rajonal ose lokal, duhet të fillojë transmetimin 6 muaj pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence.

## KREU II

### PROCEDURA E KONKURIMIT DHE DORËZIMIT TË APLIKIMIT PËR LICENCË

## Neni 6

### Çelja e konkurrimit

1. AMA, me nismën e vet, ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, duke pasur parasysh ekzistencën e frekuencave të lira për transmetimet audio analoge:

a) përcakton zonën e mbulimit me transmetim audio, për të cilën mund të nisë procedura e depozitimit të aplikimeve;

b) çel garën për dhënien e licencës së transmetimit audio dhe miraton dokumentacionin për licencim.

2. Për përcaktimin e hapësirës së mbulimit, me transmetim audio AMA organizon studimin përkatës ku mbështetet në:

a) Interesat, pritshmëritë dhe dëshirat e publikut në këtë zonë mbulimi;

b) Ndikimin në sektorin e transmetimeve në këtë zonë;

c) Larminë e shërbimeve të programeve në zonën e mbulimit.

3. Rezultatet e studimit sipas pikës 2 të këtij neni publikohen në faqen e internetit të AMA-s.

4. Subjektet e interesuara për licencë për transmetime audio analoge paraqesin pranë AMA-s letrën e interesit, ku përshkruhet:

a) Shërbimi i kërkuar (transmetim audio).

b) Lloji i licencës së transmetimit (kombëtare, rajonale ose lokale).

c) Zona e shërbimit.

ç) Prezantim i shkurtër i subjektit të interesuar.

## Neni 7

### Shpallja e procedurës së licencimit

1. AMA shpall publikisht çeljen e garës për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge në faqen e internetit të saj dhe në një organ shtypi, që shpërndalet në zonën e mbulimit me transmetim audio për të cilën është çelur gara.

2. Njoftimi për shpalljen e garës përfshin ftesën e të gjitha palëve të interesuara për depozitimin e aplikimit përkatës, duke propozuar natyrën e shërbimit të transmetimit audio, për të cilën konkurrohet. Në njoftim përcaktohen procedurat që duhen ndjekur për bërjen e aplikimit dhe kërkesat përkatëse.

3. Aplikimet për licencë bëhen brenda 40 ditëve nga shpallja e garës dhe duhet të përshkruajnë mënyrën e planifikuar të ofrimit të shërbimit dhe plotësimin e kriterëve të shpallura paraprakisht nga AMA.

## Neni 8 Tërheqja e dokumentacionit të konkurrimit

1. Subjekti i interesuar për t'u pajisur me licencë transmetimi audio analoge duhet të pajiset me dokumentacionin e licencimit.
2. Dokumentacioni i licencimit që do t'u vihet në dispozicion subjekteve që do të shfaqin interes për t'u licencuar, do të tërhiqet nga zyra e protokollit të AMA-s, pas kryerjes së pagesës së pakthyeshme në masën 1,000 (njëmijë) lekë pranë Drejtorisë përkatëse.
3. Dokumentacioni i licencimit, i miratuar nga AMA përfshin:
- a) Rregulloren "Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge".
  - b) Kërkesat që duhet të plotësojë aplikimi.
  - c) Kriteret teknike për ofrimin e shërbimit audio përfshirë frekuencën/frekuencat dhe pikën/pikat e transmetimi për zonën e shërbimit.
  - ç) Pagesat për licencën, tarifat përkatëse dhe mënyrën e pagesës së tyre.

## Neni 9 Sqarimet mbi dokumentacionin e licencimit

1. Jo më vonë se 20 ditë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimit, çdo subjekt që ka tërhequr dokumentacionin për licencim mund të kërkojë sqarime me shkrim nga AMA për këtë dokumentacion.
2. Sqarimet e bëra nga AMA mbi dokumentacionin për licencim, pavarësisht kërkesës së një ose më shumë subjektsh, do t'u njoftohen të gjithë subjekteve që kanë tërhequr dokumentacionin për licencim dhe do të publikohen në faqen zyrtare të AMA-s.

## Neni 10 Aplikimi

1. Aplikimi për licencë mund të dërgohet me postë, ose të depozitohet dorazi në protokollin E AMA-s, brenda datës dhe orës së përcaktuar në njoftimin për shpalljen e garës. Ai duhet të jetë i mbyllur në zarf, të jetë i vulosur, i firmosur dhe me mbishkrimin ku të saktësohet "*Aplikim për marrje licence transmetimi audio analoge*". Në të duhet të pasqyrohet në mënyrë të qartë, identiteti dhe adresa e saktë e aplikuesit. Aplikimet e depozituara pas afatit të dorëzimit nuk i nënshtrohen procesit të shqyrtimit dhe arkivohen.
2. Dokumentet e aplikimit, përfshirë dokumentet me vulë elektronike, që lëshohen nga Institucionet shtetërore, duhet të jenë marrë jo më vonë se 40 ditë përpara datës së aplikimit.
3. Aplikimi duhet të nënshkruhet në çdo fletë nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.
4. Dokumentacioni i aplikimit duhet të paraqitet origjinal ose i njësuar me të dhe nuk i kthehet aplikuesit.
5. Aplikuesi që ka depozituar aplikimin para afatit të dorëzimit, kundrejt një kërkesë, ka të drejtë t'a tërheqë atë, apo t'a plotësojë aplikimin, me përjashtim të ditës, që i korrespondon datës së hapjes së aplikimit. Në rast të tërheqjes të aplikimit të dorëzuar përpara afatit të përcaktuar si afat përfundimtar për dorëzimin e aplikimit, pagesa e kryer për përpunimin administrativ të aplikimit, i kthehet aplikuesit, në numrin e llogarisë bankare të tij.

## KREU III PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR LICENCË

### Neni 11 Kërkesat ligjore

1. Licenca kombëtare e transmetimit audio u jepet vetëm shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.

2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri, mbajtëse të një licence kombëtare për transmetim audio apo licencë kombëtare e transmetimit audioviziv, janë nominative.

3. Në kuptim të këtij neni, aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë.

1. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë Kombëtare transmetimi audio, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale.

2. Licenca lokale apo rajonale e transmetimit audio u jepet personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, me objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.

6. Një person fizik ose juridik që ka 100 për qind të aksioneve në një shoqëri që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, mund të marrë vetëm një licencë transmetimi audiovizive lokale apo rajonale.

7. Një person fizik ose juridik që ka aksione në një subjekt që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale, nuk mund të ketë më shumë se 40 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë transmetimi audio lokale apo rajonale.

8. Licenca kombëtare, rajonale ose lokale e transmetimit audio nuk u jepet subjekteve që u është hequr ose u është bërë e pavlefshme licenca, me vendim të AMA-s, nëse nuk ka kaluar të paktën një periudhë 10-vjeçare nga data kur i është hequr licenca e transmetimit. I njëjti kufizim zbatohet edhe ndaj subjekteve juridike, aksionarë të cilëve janë individë që kanë qenë aksionarë në subjektet të cilëve iu është hequr licenca me vendim të AMA-s.

9. Licenca kombëtare, rajonale ose lokale e transmetimit audio nuk u jepet personave të dënuar për një vepër penale, nëse nuk kanë kaluar 5 (pesë) vjet nga përfundimi i këtij dënimi.

## **Neni 12** **Dokumentacioni i aplikimit**

1. Aplikuesi për licencë kombëtare, rajonale ose lokale transmetimi audio duhet të plotësojë kërkesat për kualifikim si më poshtë:

a) Aplikimin për marrjen e licencës së transmetimit audio analoge, i cili duhet të përmbajë:

- i. Emërtimin, vendndodhjen, formën ligjore të subjektit juridik që bën kërkesën bashkë me dokumentacionin e përfaqësuesit të aplikantit, prokur/autorizim.
- ii. Parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën kërkohet licenca.
- iii. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit.
- iv. Projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave dhe territorin që do të mbulojë.
- v. Emërtimin e shërbimit të programit audio.
- vi. Deklarimin e aplikuesit se përmbajtjet e programeve që do të transmetohen do të jenë në përputhje me parimet themelore, sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 97/2013, si dhe me kërkesat e Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive.
- vii. Dokumentacionin që vërteton të drejtën e transmetimit të programeve (kontratë për kalimin e të drejtave të transmetimit si shitje, dhurimi ose shkëmbimi).
- viii. Informacion mbi strukturën e pronësisë së subjektit aplikues, vetitë, ekspertizën e organeve drejtuese, administratorëve, apo agjencive të tjera të shoqërisë, apo pronarëve.
- ix. Deklaratë mbi numrin e punonjësve që parashikon të punësojë;
- x. Organizimin dhe drejtimin e shoqërisë (organigrama), lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit të firmosura (për subjektet rajonale dhe lokale minimumi është 5 anëtarë, ndërsa për subjektet kombëtare minimumi është 7 anëtarë).
- xi. Adresën e detajuar të ambientit (studios) ku janë të instaluar pajisjet audio transmetuese të

subjektit, e shoqëruar me kopje të noterizuar të dokumentit të pronësisë. Në rast se subjekti ka më shumë se një ambient (studio), adresat e detajuara të secilës prej tyre. Në rast se ambienti nuk është në pronësi të aplikuesit, së bashku me dokumentin e pronësisë duhet të depozitohet edhe dokumenti që vërteton të drejtën e tij të shfrytëzimit (kontratë përdorimi, qiraje, etj.).

xii. Pagesën për përpunimin e dokumentacionit për licencë për transmetim audio kombëtar, rajonal ose lokal.

Faqe | 6

b) Dokumentacionin ligjor si më poshtë vijon:

- i. Regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me gjithë ndryshime (nëse ka), forma ligjore, emërtimi i subjektit, lista e aksionarëve me aksionet/kuotat respektive me status aktiv.
- ii. Në rastin kur njëri nga ortakët e subjektit aplikues është person juridik, duhet të paraqitet ekstrakti për të dhënat e tij si dhe lista e aksionarëve të tij.
- iii. Deklaratë noteriale të secilit prej aksionarëve/ortakëve të subjektit aplikues lidhur me kuotat e zotëruara prej tyre në shoqëri të tjera audio ose audiovizive dhe në rast se aksionari/ortaku i subjektit është person juridik, kjo deklaratë noteriale nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjor i subjektit, ortak/aksionar i shoqërisë aplikuese.
- iv. Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionarëve/ortakëve të subjektit.
  - v. Adresë, nr. tel, fax, e-mail.
  - vi. Personin përfaqësues.
  - vii. Deklaratën për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura.

c) Dokumentacionin teknik si më poshtë vijon :

- i. Përshkrimin e përgjithshëm të shërbimit audio që do të ofrohet.
- ii. Formularin e aplikimit sipas aneksit 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
- iii. Projektin/et teknike të studios/ve si dhe vendndodhjen e studios; projektin/et teknike të pikave të transmetimit, ku të përshkruhen pajisjet radio në përdorim, sistemin e antenave (diagrama/t “H” dhe “V” të antenës/ave transmetuese), paternet e rrezatimit, mënyrën e transmetimit të sinjalit nga studio në pikën e transmetimit, identifikimin i sistemit RDS, shoqëruar me:
  1. bllokskemën e organizimit të të gjithë rrjetit të transmetimit;
  2. bllokskemën e studios së transmetimit;
  3. simulimet e mbulimit me sinjal të pikave të transmetimit.
- iv. Përshkrim i shkurtër i sistemit të antenave, paternet e rrezatimit, si dhe të përshkruhet çdo filtër ose pajisje izoluese midis daljes së transmetuesit dhe sistemit të antenave.
- v. Përshkrim të shkurtër të rrjetit lidhur me shërbimet fikse, frekuencat e të cilave administrohen nga AKEP, si dhe një deklaratë ku angazhohet se pas licencimit në AMA, do të aplikojë në AKEP për t’u pajisur me Autorizim Individual për lidhje fikse pikë-pikë, nëse aplikuesi parashikon të përdorë lidhje fikse për ndërtimin e rrjetit të transmetimit.
- vi. Projektin teknik të studios së prodhimit të përmbajtjeve audio.
- vii. Listën e pajisjeve të transmetimit aktive dhe pasive dhe pajisjeve të studios (emërtimi i pajisjes, prodhuesi dhe modeli), e paraqitur në formë tabelare.
- viii. Projektin teknik, i cili duhet të hartohet nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor);
- ix. Procedurat që do të ndjekë për sigurinë teknike dhe mirëmbajtjen e rrjetit.
- x. Afatin e propozuar për përfundimin e rrjetit.
- xi. Ofrimin e shërbimeve audio me cilësi të lartë në zonën për të cilën aplikon, bazuar në standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare.
- xii. Mbulim me sinjal radio FM tokësore, sipas Rekomandimit ITU-R, BS 412-9 të ITU, do të konsiderohet mbulimi i zonës së licencimit me intensitet fushe jo më të vogël se:
  1. 70 dBμV/m (mono) dhe 74 dBμV/m (stereo) për qytete të mëdha;
  2. 60 dBμV/m (mono) dhe 66 dBμV/m (stereo) për zona urbane;

Në rastin e mungesës së interferencave të emetuara nga pajisje vendore, industriale, niveli i intensitetit të fushës (matur në lartësinë 10m mbi nivelin e tokës) do të konsiderohet i pranueshëm për shërbimin mono dhe stereo në vlerat 34 dB $\mu$ V/m (mono) dhe 48 dB $\mu$ V/m (stereo).

Këto vlera aplikohen kur për marrje mono do të konsiderohet antenë jashtë godine, ose për marrje stereo do të konsiderohet një antenë e drejtuar me përforsim të caktuar (sistemi pilot- tone, sipas përcaktimeve të rekomandimit ITU-R BS.450).

xiii. Pajisjet që do të përdoren duhet të projektohen, ndërtohen, mirëmbahen dhe shfrytëzohen në mënyrë që përdorimi i tyre të mos shkaktojë asnjë interferencë të dëmshme tek asnjë përdorues tjetër i spektrit të radiofrekuencave.

xiv. Parashikimin e sinjalit RDS (sistem i të dhënave radio) në mënyrë që të identifikohet logoja e radios.

xv. Subjekti para daljes në transmetim, duhet të njoftojë në AMA parametrat teknik për çdo pikë transmetimi, me qëllim përputhjen e kushteve të licencës me ato të realizuara faktikisht.

xvi. Subjekti duhet të njoftojë në AMA për çdo ndryshim në rrjetin e transmetimit duke dhënë arsytet përkatëse.

#### ç). Dokumentacioni financiar:

i. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të nënshkruar të shoqërisë, në vlerën jo më pak se 3,500,000 lekë, i cili duhet të jetë i vërtetuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në rastin e aplikimit për licencë kombëtare të transmetimit audio.

ii. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të nënshkruar të subjektit juridik, në vlerën jo më pak se 2,500,000 lekë, i cili duhet të jetë i vërtetuar ose në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe/ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/ autorizuar ose audituesi ligjor në rastin e aplikimit për licencë rajonale të transmetimit audio.

iii. Të dhëna për kapitalin e deklaruar dhe të nënshkruar të subjektit juridik, në vlerën jo më pak se 1,00,000 lekë, i cili duhet të jetë i vërtetuar ose në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe/ose të vërtetuar nga eksperti kontabël i miratuar/ autorizuar ose audituesi ligjor në rastin e aplikimit për licencë lokale të transmetimit audio.

iv. Parashikimi për shpenzimet dhe të ardhurat për periudhën e vlefshmërisë së licencës duke përcaktuar llojet e të ardhurave (reklama, të ardhura nga të tretët, të ardhura nga shërbimi etj), shpenzimet fikse, të ndryshueshme, detyrimet tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, investimet, si dhe origjinën dhe vlerën e mbulimit të shpenzimeve dhe investimeve që parashikohen të kryhen gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës;

v. Garancia bankare që vërteton se aplikuesi ka ngurtësuar shumën prej 10% të vlerës së kapitalit financiar të kërkuar, duke filluar nga data e paraqitjes së aplikimit, për një periudhë deri 12 muaj për aplikimet për licencë kombëtare dhe deri në 6 muaj për aplikimet për licencë lokale ose rajonale.

vi. Garancia bankare ç'ngurtësohet para afatit në rast se:

- a) Subjekti i pajisur me licencë ka dalë në transmetim dhe ka kryer pagesën për licencë dhe tarifë;
- b) Subjekti i është refuzuar aplikimi për licencë.

#### d) Dokumentacioni i programeve:

1. Aplikuesi për licencë kombëtare, rajonale apo lokale të transmetimit audio duhet të garantojë, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, se në përmbajtjen e programeve të tyre do të përmbushi standardet programore duke:

- i. Nxitur vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e shprehjes

dhe të informimit.

ii. Respektuar paanshmërinë, plotësinë e pluralizmin e informacionit. Paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë të ndershme, inkurajimin në formimin e lirë të opinionëve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie, organizate politike, grupimi ekonomik apo komuniteti e shoqate fetare.

Faqe | 8 iii. Respektuar mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë.

iv. Promovuar kulturën kombëtare shqiptare dhe gjuhën shqipe.

v. Promovuar kulturën evropiane, të mbajë në konsideratë nevojën e formimit të opinionit publik për t'u njohur dhe për të kuptuar vlerat dhe traditat evropiane.

vi. Promovuar kulturën e pakicave kombëtare.

vii. Ofruar mundësi për promovim të krijuesve të rinj në fushën e muzikës, radio-dramatizimeve dhe sidomos ato të lidhura me kulturën kombëtare.

viii. Ofruar një shumëllojshmëri shërbimesh në territorin e RSH-së për kategoritë e ndryshme shoqërore, përfshirë këtu interesat e pakicave;

ix. Promovuar bashkëpronësinë dhe kolegjalitetin në vendimmarrjet editoriale;

x. Respektuar dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;

xi. Respektuar privatësinë e individit;

xii. Respektuar diversitetin fetar dhe racën;

xiii. Respektuar ruajtjen e sekretit të burimeve të informacionit;

xiv. Respektuar normat morale dhe etike të shoqërisë;

xv. Respektuar të drejtën e përgjigjes;

xvi. Respektuar, mbrojtur dhe promovuar të drejtat e fëmijëve, në të gjitha llojet e programeve dhe në programe të posaçme audio për fëmijët.

2. Strukturën programore të propozuar, e cila duhet të përmbajë, pavarësisht nga lloji i aplikimit për licencë kombëtare, rajonale apo lokale, të dhëna dhe raporte që në tërësinë e tyre shprehin qartë pluralizmin dhe paanësinë e informacionit;

3. Përshkrimin e përmbajtjes së programeve kryesore të prodhuara nga vetë aplikuesi (dhe të dhëna për kohëzgjatjen e secilës) që garantojnë cilësinë e informacionit, promovimin e gjuhës e të kulturës kombëtare, larminë e programeve për fëmijë e të rinj, si dhe çështje specifike të traditës e zhvillimeve rajonale e lokale;

4. Të dhëna statistikore për strukturën e programeve audio (përqindjen që zënë psh. Informacioni, kulturë, art, argëtimi dramatizimi, sporti, fëmijët dhe të rinjtë, reklama etj);

5. Programin javor të transmetimit.

6. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme, si dhe mosrespektimi i nenit 11 të kësaj rregulloreje është kusht skualifikues dhe përbën shkas për rrëzimin e aplikimit.

7. Dokumentacioni i aplikimit të shoqërohet me inventar dhe të pasqyrohet emërtimi i dokumentave të dorëzuara dhe numrat rendorë për çdo dokument.

### Neni 13

#### Kriteret e vlerësimit me pikë të aplikimeve për licencë transmetimi

1. Kriteret e pikëzimit për aplikimet për licencë transmetimi kombëtare, rajonale ose lokale, të cilat i nështrohen vlerësimit me pikë, janë:

a) Struktura programore:

**70 pikë**

i. Programe të përgjithshme

a. Programe informative

2 njësi

b. Programe për fëmijë

3 njësi

c. Program për minoritete

2 njësi

ç. Programe edukative

3 njësi

d. Programe të aktualitetit

2 njësi



dh. Radio-dramatizime	2 njësi
e. Programe argëtuese	2 njësi
ë. Quiz	2 njësi
f. Programe sportive	2 njësi
g. etj.	2 njësi

**Totali 22 njësi**

Faqe | 9

ii. Programe tematike:	
a. Programe informative	5 njësi
b. Program për fëmijë	10 njësi
c. Larmia brenda tematikës	5 njësi
ç. etj	2 njësi

**Totali 22 njësi**

2. Vlerësimi i tërësisë së programeve bëhet duke mbledhur njësitë e grumbulluara gjatë vlerësimit për shërbimin programor (të përgjithshëm ose tematik), e cila quhet shumatore e njësive ( $\Sigma N$ ). Numri i njësive maksimale është 22 njësi.

3. Llogaritja e pikëve bëhet sipas formulës  $P = \Sigma N / 22 * 70$ .

4. Llogaritja e pikëve sipas kësaj formule bëhet vetëm, ose për programin tematik, ose për programin e përgjithshëm dhe, në numrin total të pikëve, shtohet vetëm 1 shumë.

b) Vlerësimi i kritereve financiare: **30 pikë**

- Kapaciteti mesatar i vetëfinancimit për mbulimin e shpenzimeve dhe investimeve: 10 pikë
- Kapaciteti mesatar i financimit nga palë të treta (kredi bankare ose palë të lidhura me subjektin për mbulimin e shpenzimeve dhe investimeve: 20 pikë

## KREU IV SHQYRTIMI DHE VENDIMMARRJA MBI APLIKIMET

### Neni 14 Vlerësimi i dokumentacionit të aplikimit për licencë

- Shqyrtimi i aplikimeve për marrje licence transmetimi audio, rinovim, zgjerim ose ndryshim të zonës së mbulimit dhe rinovimin e licencës kryhet nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD), i ngritur me urdhër të Kryetarit të AMA-s.
- Në rastet e aplikimeve për marrje licence transmetimi audio dhe zgjerim ose ndryshim të zonës së mbulimit, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD), kryesohet nga Zëvendëskryetari i AMA-s, pa të drejtë vote.
- Anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit mbajnë përgjegjësi për saktësinë e përpunimit të të dhënave të akteve të sipërcituara, si dhe për ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve me të cilat njihen gjatë këtij procesi.
- Informacionet në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve nuk duhet t'u bëhen të njohura aplikuesve ose personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces.

### Neni 15 Procedura e shqyrtimit të aplikimit

- Aplikimet për marrje licence transmetimi audio, zgjerim të zonës së mbulimit dhe rinovimin e licencës, administrohen në prani të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit dhe merren në shqyrtim vetëm dosjet e aplikimit që rezultojnë të mbyllura,

- dhe të vulosura. Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit verifikon nëse subjekti ka kryer Pagesën për Përpunimin e Dokumentacionit (PPD) dhe në rast se subjekti nuk e ka paguar PPD, dosja e aplikimit të tij nuk i nënshtrohet shqyrtimit dhe arkivohet.
2. Pas verifikimit të kushteve të pikës 1 të këtij neni, vijon identifikimi i të gjithë dokumentacionit që përmban dosja e aplikimit.
  3. Komisioni, pas hapjes së dosjes së aplikimit, verifikon paraprakisht nëse dokumentacioni i aplikimit i paraqitur nga subjektet që kërkojnë të pajisen me licencë është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje. Në rast se dokumentacioni nuk është konform akteve të sipërpërmendura, subjekti aplikues skualifikohet dhe aplikimi i tij, pavarësisht vlerësimit nga anëtarët e KSHD-së, nuk i nënshtrohet vlerësimit me pikë.
  4. Aplikimi i subjektit, dokumentacioni i të cilit, rezulton në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, shqyrtohet në mënyrë tërësore nga anëtarët e KSHD-së dhe i nënshtrohet vlerësimit me pikë.
  5. Relacionet e vlerësimit individuale të secilit anëtar të Komisionit, përgatiten dhe i dorëzohen Drejtorisë Ligjore, jo më vonë se 3 ditë nga marrja në dorëzim të dosjes së aplikimit përkundrejt nënshkrimit në procesverbalin e vlerësimit të aplikimit.
  6. Pas mbledhjes së relacioneve të vlerësimit të të gjithë anëtarëve, Drejtoria Ligjore, përgatit relacionin përmbledhës, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit, një kopje e të cilit i përcillet Kryetarit të AMA-s.
  7. Relacioni përfundimtar përmbledhës i vlerësimit, së bashku me gjithë relacionet individuale të anëtarëve të Komisionit, si dhe propozimi përkatës i Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit në lidhje me aplikimin e subjektit, i paraqiten AMA-s në mbledhje për vendimmarrje.
  8. AMA miraton procedurën e ndjekur të vlerësimit dhe në rast se konstaton mangësi në respektimin e tyre, ka të drejtë të kërkojë kryerjen e një vlerësimi të ri.
  9. Në rast se në përfundim të procesit të vlerësimit, rezulton se dy ose më shumë subjekte aplikues, për të njëjtën zonë ofrimi shërbimi, do të rezultojnë me pikë të njëjta, Bordi i AMA-s, ka të drejtë të japë licencën përmes procedurës me short
  10. Gjatë procedurës së shqyrtimit të dosjeve të aplikimit mbahet procesverbal, nga sekretari i AMA-s, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit.

### **Neni 16** **Procedura e Shortit**

1. Bordi i AMA-s, organizon dhe vendos procedurën e shortit me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të subjekteve aplikues që do të jenë subjekt i shortit.
2. Përfaqësuesit e subjekteve aplikues do të ftohen të marrin pjesë në datën, kohën dhe vendin e përcaktuar nga AMA nëpërmjet shërbimit postar rekomande. Mungesa e përfaqësuesve të OSHMA nuk do të pengojë vazhdimin e procedurës së shortit.
3. Shorti do të realizohet nëpërmjet tërheqjes së emrave të shënuar për çdo subjekt aplikues.
4. Procedura e shortit pasqyrohet në një procesverbal të mbajtur nga KSHD.

### **Neni 17** **Vendimmarrja**

1. Vendimi për dhënien ose mosdhënien e licencës së transmetimit audio analoge jepet nga AMA jo më vonë se 60 ditë, duke filluar ky afat nga data e përcaktuar për depozitimin e aplikimit.
2. Licenca e transmetimit audio u jepet subjekteve që vlerësohen jo më pak se 75 pikë.
3. Kërkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen në rastin e aplikimit për rinovimin e licencës së transmetimit audio analoge.
4. Rrëzimi i aplikimit për dhënien e licencës, si dhe mosrinovimi i licencës bëhet gjithmonë kundrejt një vendimi të arsyetuar.

5. Kundër vendimit të AMA-s sipas këtij neni, aplikuesi mund të bëjë ankim në gjykatë, sipas, ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

## Neni 18

### Rinovimi i licencës së transmetimit audio analoge

Faqe | 11

1. Aplikimi për rinovimin e licencës së transmetimit audio analoge duhet të bëhet të paktën 90 ditë përpara përfundimit të afatit të licencës.
2. Kërkesat e aplikimit për rinovimin e licencës së transmetimit audio analoge janë të njëjta me atë të aplikimit për marrje licence transmetimi audio analoge.
3. Aplikimi për rinovimin e licencës së transmetimit audio analoge nuk i nënshtrohet vlerësimit me pikë. Në rastin e mungesave në dokumentacion apo parregullsi të konstatuara në dokumentacionin e aplikimit për rinovimin e licencës, Kryetari i AMA-s, pas propozimit të Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, ngritur sipas kësaj rregulloreje, mund të vendosë t’i caktojë një afat të ri, subjektit aplikues për rinovimin e licencës së transmetimit audio analoge, për plotësimin e mangësive, apo parregullsive të konstatuara në dokumentacion, por duke mos tejkaluar afatin e përfundimit të licencës.
4. AMA, gjatë procesit të rinovimit të licencës verifikon edhe:
  - i. Respektimin e kushteve të mëparshme të licencës, ku përfshihen:
    - a) realizimi i mbulimit të zonës së licencimit (sipas territorit dhe sipas popullsisë);
    - b) respektimin e kushteve të licencës për sa i përket programeve, formati dhe struktura programore;
    - c) Respektimin e të drejtave të transmetimit dhe autorit.
  - ii. Detyrimet financiare për periudhën e ushtrimit të aktivitetit ku përfshihen:
    - a) pagesa vjetore për licencë përtej vitit kalendarik në të cilin bëhet shqyrtimi i aplikimit për rinovim licence;
    - b) pagesa për tarifën e shërbimeve radiotelevizive përtej vitit kalendarik në të cilin bëhet shqyrtimi i aplikimit për rinovim licence;
    - c) ecuria e ekzekutimit të sanksioneve me gjobë të vendosura nga AMA të kthyer në titull ekzekutiv.
5. AMA refuzon aplikimin e subjektit i cili nuk ka përmbushur një nga pikat e mësipërme të këtij neni.

## Neni 19

### Zgjerimi i zonës së mbulimit dhe ndryshimi i kushteve të licencës

1. Kërkesat e aplikimit për zgjerimin e zonës së mbulimit të transmetimit audio janë të njëjta me atë të aplikimit për marrje licence transmetimi audio analoge.
2. Subjekti i cili kërkon të ndryshojë kushtet e licencës së transmetimit audio, depoziton pranë AMA-s, kërkesën e arsyetuar.
3. AMA, ndryshon kushtet e licencës së transmetimit audio me nismën e vet:
  - a) kur ka ndryshuar Plani Kombëtar i Frekuencave ose Plani i Përdorimit të Frekuencave ose rregullat për kushtet e përdorimit të frekuencave
  - b) për nevoja publike, që nuk mund të plotësohen në mënyrë tjetër;
  - c) kur ndryshimi i kërkuar i shërben përdorimit eficient të frekuencave dhe është me interes publik;
  - d) kur interferencat e dëmshme nuk mund të shmangen në mënyrë tjetër;
  - e) kur ndryshimi buron nga aktet ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.
4. I licencuari përballon, me shpenzimet e veta, kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme, që burojnë nga ndryshimet në kushtet e licencës së transmetimit audio.

## **Neni 20** **Detyrimet financiare**

Faqe | 12

1. Pagesat për marrjen e licencës, pagesa vjetore e licencës, pagesa për përpunimin e dokumentacionit për licencë për transmetim audio kombëtar, rajonal ose lokal, do të kryhen bazuar në vendimin e AMA-s, në fuqi për përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga AMA.
2. Pagesa vjetore kryhet brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik. Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet kamatëvonesë në masën 0.1% të vlerës së detyrimit të mbetur për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 30% e vlerës së pagesës vjetore. Detyrimi i lindur në formën e kamatëvonesës së vitit paraardhës dhe i palikuiduar brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, përfshihet në pagesën vjetore për licencë të vitit pasardhës.
3. Pagesat për marrjen e licencës, pagesat vjetore të licencës, pagesat për përpunimin e dokumentacionit për licencë për transmetim audio kombëtar, rajonal ose lokal, mund të jenë objekt ndryshimi me vendim të Autoritetit të Mediave Audiovizive në përputhje me legjislacioni në fuqi në fushën e mediave.
4. Tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive do të kryhet bazuar në legjislacionin në fuqi për taksat dhe tarifat.

## **Neni 21** **Heqja dhe pavlefshmëria e Licencës**

Heqja dhe pavlefshmëria e licencës bëhet në zbatim të parashikimeve të nenit 68 dhe 69 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **KREU V** **DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

### **Neni 22** **Shqyrtimi i aplikimeve të bëra përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje**

Aplikimet për marrjen e licencës së transmetimit audio si dhe për rinovimin e licencës së transmetimeve audio, të bëra para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, por që, për të cilat ende nuk është marrë një vendim, do të shqyrtohen në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë qenë në fuqi në datën e paraqitjes së aplikimeve.

### **Neni 23** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.



## ANEKSI 1: FORMULAR APLIKIMI PËR CAKTIMIN DHE PËRDORIMIN E FREKUENCAVE AUDIO

<b>1.</b>	<b>SUBJEKTI</b>			
1.1.	Emri i Shoqërisë:			
1.2.	Forma Ligjore:	<input type="checkbox"/> sh.p.k.	<input type="checkbox"/> sh.a.	
1.3.	Emri i Operatorit OSHMA:			
1.4.	NIPT:			
1.5.	Adresa:			
1.6.	Telefon/ Faks/ Cel:	Tel:	Fax:	Cel:
1.7.	E-mail:			
<b>2.</b>	<b>FREKUENCA E SUBJEKTIT OSHMA</b>			
2.1.	Frekuenca e transmetuesit (MHz/ KHz):			
2.2.	Numri i kanalit:			
2.3.	Koha e punës:			
<b>3.</b>	<b>TË DHËNA MBI PAJISJEN RADIO</b>			
3.1.	Prodhuesi dhe modeli i pajisjes:			
3.2.	Numri serial i pajisjes:			
3.3.	Fuqia e kërkuar dhe fuqia e lejuar e transmetuesit (Ë/kË):			
3.4.	Lloji i emetimit:			
3.5.	Pajisja RDS:	<input type="checkbox"/> PO		
<b>4.</b>	<b>VENDNDODHJA E PIKËS SË TRANSMETIMIT</b>			
4.1.	Emërtimi i pikës së transmetimit:			
4.2.	Koordinatat gjeografike:			
4.3.	Lartësia mbi nivelin e detit (m):			
<b>5.</b>	<b>SISTEMI I ANTENAVE</b>			
5.1.	Fuqia maksimale izotropike efektive e rrezatuar - EIRP (Ë):			
5.2.	Amplifikimi (dBi):			
5.3.	Humbjet në kabull (dB):			
5.4.	Lartësia e antenës mbi nivelin e tokës (m):			
5.5.	Azimuthi (°):			
5.6.	Tilt-i (°):			
5.7.	Lloji i rrezatimit të Antenës (Drejtuar/Rrethore):			
5.8.	Lloji i antenës:			

## 6. SHËNIME

6.1.

Faqe | 14

**A. Dokumentacioni teknik bashkëlidhur këtij formulari për "Dhënie Licence Transmetimi", si dhe për zgjerim të zonës së mbulimit:**

- Përshkrim i përgjithshëm i shërbimit audio që do të ofrohet
- Projekti/et teknike të studios/ve si dhe vendndodhja e studios; projekti/et teknike të pikave të transmetimit, ku të përshkruhen pajisjet radio në përdorim, sistemi i antenave (diagrama/t "H" dhe "V" të antenës/ave transmetuese, paternet e rrezatimit, mënyra e transmetimit të sinjalit nga studio në pikën e transmetimit, identifikimi i sistemit RDS, shoqëruar me:
  - bllokskemën e organizimit të të gjithë rrjetit të transmetimit;
  - bllokskemën e studios së transmetimit;
  - simulimet e mbulimit me sinjal të pikave të transmetimit.

Përshkrim i shkurtër i sistemit të antenave, si dhe të përshkruhet çdo filtër ose pajisje izoluese midis daljes së transmetuesit dhe sistemit të antenave.

- Nëse aplikuesi parashikon të përdorë lidhje fikse për ndërtimin e rrjetit të transmetimit duhet të paraqesë një përshkrim të shkurtër të rrjetit lidhur me shërbimet fikse, frekuencat e të cilave administrohen nga AKEP, si dhe një deklaratë ku angazhohet se pas licencimit në AMA, do të aplikojë në AKEP për t'u pajisur me Autorizim Individual për lidhje fikse pikë-pikë.
- Projektin teknik i studios së prodhimit të përmbajtjeve audio;
- Lista e pajisjeve të transmetimit aktive dhe pasive dhe pajisjeve të studios (emërtimi i pajisjes, prodhuesi dhe modeli), e paraqitur në formë tabelare; Projekti teknik të hartohet nga një inxhinier elektronik i pajisur me diplomën përkatëse (Master Shkencor);
- Procedurat që do të ndjekë për sigurinë teknike dhe mirëmbajtjen e rrjetit.
- Afati i propozuar i përfundimit të rrjetit.

**B. Dokumentacioni teknik bashkëlidhur këtij formulari për rinovim licence:**

1. Subjekti duhet të vetdeklarojë se operon në përputhje me kushtet e licencës.
2. Subjekti duhet të paraqesë dokumentacion teknik vetëm në rastin kur gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij kanë ndodhur ndryshime në rrjet për shkak të defekteve gjatë operimit të aparaturave, zëvendësimet, ndërhyrjet në linjat e transmetimit, sistemit të filtrave apo antenave.
3. Referuar pikës 2, subjekti duhet të përshkruajë ndryshimet e ndodhura, duke e shoqëruar me këtë formular.
4. Procedurat që ndjek për sigurinë teknike dhe mirëmbajtjen e rrjetit (shoqëruar nëse ka, me Kontratë shërbimi mirëmbajtje).

Unë konfirmoj se të dhënat në këtë formular dhe të dhënat shtesë bashkëlidhur këtij formulari janë të sakta dhe të vërteta.

Emër Mbiemër: \_\_\_\_\_

Firma: \_\_\_\_\_

Vula:

